



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KESHILLI BASHKIAK
GRAMSH

Nr. 1634/2 Prot

Gramsh më 25/05/2026

VENDIM
Nr 28 Date 30/04/2026

**PËR
MIRATIMIN E PLANIT LOKAL TË VEPRIMIT 2026-2030 PËR BARAZI,
PËRFSHIRJE DHE PJESËMARRJE TË ROMËVE DHE EGJIPTIANËVE NË
BASHKINË GRAMSH**

Keshilli Bashkiak ne mbledhjen e dates 30.04. 2026,pasi mori në shqyrtim Relacionin e Drejtorisë së Shërbimeve dhe Mbrojtjes Sociale , Për,Planin Lokal të Veprimit për Barazi,Përfshirje dhe Pjesëmarrje te Romëve dhe Egjiptianëve 2026-2030 për Bashkinë Gramsh, mbështetur në Ligji 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, si dhe ligji 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror”.

VENDOSI:

1. Të miratojë Planin Lokal të Veprimit për Barazi,Përfshirje dhe Pjesëmarrje te Romëve dhe Egjiptianëve 2026-2030 për Bashkinë Gramsh nga i cili synohet të arrihen objektivat e mëposhtëm:
 - Anëtarët e pakicave rome dhe egjiptiane në Bashkinë Gramsh do të kenë akses të plotë në shërbimet e gjendjes civile dhe ndihmës ligjore falas, me të gjithë ata të regjistruar në regjistrat e gjendjes civile.
 - Fuqizimi ekonomik i individëve dhe familjeve nga pakicat rome dhe egjiptiane do të arrihet përmes mundësive të punësimit të rregullt dhe të qëndrueshëm.
 - Anëtarët e pakicave rome dhe egjiptiane do të kenë një nivel më të lartë arsimor dhe akses më të mirë në arsimim cilësor dhe gjithëpërfshirës, përfshirë ata që janë kthyer nga emigracioni, në Bashkinë Gramsh.
 - Ruajtja e diversitetit kulturor dhe promovimi i vlerave rome dhe egjiptiane do të jenë prioritete kyçe.
 - Anëtarët e pakicave rome dhe egjiptiane do të kenë akses të plotë në shërbimet e strehimit dhe do të jetojnë në kushte më të mira strehimi dhe infrastrukture.
 - Do të përmirësohet shëndeti dhe aksesin në shërbimet shëndetësore për anëtarët e pakicave rome dhe egjiptiane.
 - Rritja e mirëqenies sociale për këto grupe do të jetë një fokus i rëndësishëm.
 - Do të eliminohet antixhipsizmi përmes njohjes dhe edukimit të shoqërisë, për të siguruar një mjedis të lirë nga diskriminimi ndaj këtyre grupeve.

•Fuqizimi i pakicave rome dhe egjiptiane do të arrihet përmes statistikave, planifikimit dhe buxhetimit të ndjeshëm ndaj diversitetit rom dhe egjiptian

2. Per zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtorja Shërbimeve dhe Mbrojtjes Sociale.

**Sekretari Keshillit
Xhulia Gjini**



**Kryetari Keshillit
Enis Zani**

